



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**

**Nr. 272, datë 04.12.2019**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatën në nevojë si vijon:

**GJYKATA E APELIT {...}**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit {...}, çështjen penale në ngarkim të të pandehurve: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; të akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152/1, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit {...}, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit {...}, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 109/b/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR  
KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**